

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

1. Informacion i per gjithshem

Shoqeria GFI Albania sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 5 prill 2013 dhe prane Deges se Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L31605014G.

Vepрimtaria e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte ai i percaktuar ne Kontraten Koncesionare "Per sherbimin e Markimit dhe te Monitorimit te Karburanteve", te nenshkruar me date 27 shkurt 2013 midis ortakeve te Shoqerise dhe Ministrise se Financave te Republikes se Shqiperise (me poshte referuar si "Kontrata Koncesionare"). Sipas kesaj te fundit, objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte ndertimi dhe testimi i sistemit operativ per ofrimin e sherbimit te markimit dhe monitorimit te karburanteve ne Republiken e Shqiperise, shfrytezimi i sistemit operativ, dhe transferimi i pajisjeve te sistemit operativ per monitorimin e karburanteve ne Republiken e Shqiperise tek Ministria e Financave pas perfundimit te afatit te Koncesionit. Kontrata e Koncesionit ka nje afat dhjetevjecar nga data efektive e saj.

Shoqeria zoterohet nga ortaket Petroleum Consulting Partners A.G. dhe Global Fluids International S.A., te cilet me 31 dhjetor 2017 zoterojne respektivisht 99.93% dhe 0.07% te kapitalit themeltar.

Administratoret e Shoqerise jane Z. Vangjel Birbo dhe Z. Dorian Deltina. Secili prej administratoreve ka kompetence per te perfaqesuar Shoqerine i vetem.

Selia kryesore e Shoqerise ndodhet ne Rrugen "Murat Toptani", Eurocol Business Center, kati i dyte, Tirane dhe selia dytesore ndodhet ne Autostraden Tirane-Durres, Km. 6, Kashar, Tirane.

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2018 eshte 64 (2017: 66).

Parimi i vijimesise

Keto pasqyra financiare jane perqatitur mbi bazen e vijimesise. Kapitali i per gjithshem i Shoqerise eshte ne vlera pozitive per te tretin vit radhazi.

2. Bazat e perqatitjes se pasqyrave

2.1 Pajtueshmeria

Pasqyrat financiare jane perqatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) ne fuqi ne Shqiperi.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane perqatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme jane riklasifikuar per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njoitura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njoitura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te me poshtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehesh ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj jane:

31 dhjetor 2018 31 dhjetor 2017

Euro/Lek	123.42	132.95
Usd/Lek	107.82	111.10

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe llogari te pagueshme.

Instrumentat financiare joderivative nijihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksiqi qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njoftueshme fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar nijhet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivit financiar ose kur Shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anullohen.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne depozita pa afat dhe depozita me nje afat maturimi prej tre muajsh ose me pak qe nga data fillestare.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa te vonuara konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdonur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njoftes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njoftur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo difference midis vleres fillestare dhe vleres se pagueshme nominale per gjate periudhes se huamarjes duke u bazuar ne metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Inventare

Inventaret percaktohen me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kostoja percaktohet duke perdonur metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera per perfitimin e inventarit dhe kosto te tjera te kryera per dergimin e inventareve ne destinacion dhe me kushtet e kerkuara. Vlera neto e realizueshme i referohet vleres neto qe Shoqeria pret te perfitoje nga shitja e inventarit, ne rrjedhen normale te biznesit, minus kostot e shitjes.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Ne rastet kur pjesa te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdonimit percaktohen duke kahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjesa te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe Shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdonimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marre per baze periudhen me te shkurter midis afatit te koncessionit dhe jetes se vleresuar te dobishme te aktivit duke filluar nga dita kur ai eshte i gatshem per perdom. Aktivet e marra me qira financiare amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat e amortizimit dhe perqindjet perkatese sipas grupeve te aktiveve afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshte:

Ndertesa	Mbi vleren kontabel neto	10%
Permiresime ne qiramarrje	Mbi vleren kontabel neto	10%
Makineri dhe pajisje	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Orendi dhe pajisje zyre	Mbi vleren kontabel neto	20%
Komputera dhe pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi.

Brenda aktiveve afatgjata jane paraqitur edhe aktivet afatgjata te cilat kane lidhje me koncessionit, per shkak te natyres materiale te ketyre aktiveve dhe vleres josinjifikative ne daten e bilancit.

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe kane nje jete te percaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes se aktivit te zgjedhur me vleren e tij te mbetur. Shuma e amortizimit kalon ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne menyre zbritese per gjate jetes se aktivit.

Shoqeria ka vetem dy programe kompjuterike te njohura ne keto pasqyra financiare, te cilat jane amortizuar mbi vleren kontabel neto me perqindje 25%.

3.6 Zhvleresimi

Aktivet financiare

Nje aktiv finanziar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin finanziar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase, te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv finanziar te disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligj apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkonte fluksete parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar fluksete parash te ardhshme te parase me nje norme skontimi qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.8 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane flukset hyrese bruto te perfitimeve ekonomike lindur ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise qe rezultojne ne rritje te kapitalit neto gjate periudhes dhe nuk perfshijnë rritjet e kapitalit neto ne saje te kontributeve te ortakeve. Te ardhurat perfshijnë vleren e drejtë te shumes se arketuar apo te arketueshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne rrjedhen normale te aktiviteve te Shoqerise. Te ardhurat nuk perfshijnë tatimin e vleres se shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nese ka.

Te ardhurat nga sherbimi i markimit

Shoqeria kryen sherbimin e markimit siç parashikohet ne Kontraten e Koncesionit. Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit. Asnjë ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese. Keto sherbime ofrohen me nje çmim fiks dhe ne menyre te vazhdueshme nga Shoqeria.

3.9 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijnë te ardhurat nga interesit per llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesit njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdonur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijnë shpenzime interesit mbi huamarjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejtë te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejtë nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje perveç nese lidhet me zera te njohur direkt ne kapital, rast ne te cilin njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatushem te vitit, duke perdonur normen tatimore ne fuqi ose qe konsiderohet ne fuqi ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave te njohura per aktivet dhe detyrimeve te shoqerise te paraqitura ne pasqyren e pozicionit financier ne perputhje me kerkesat e SKK dhe vlerave te njohura te ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

4.1 Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanise eshte i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: rishku i kursit te kembimit, rishku i kredise dhe rishku i perqindjes se interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet ne paparashikueshmerine e tregut financiar dhe synon te minimizoje efektet potenciale te papelqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar nndermerret nga departamenti financiar i kompanise meme sipas politikave te aprovuara nga bordi.

(i) Rishku nga kursi i kembimit

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit qe vjen si rezultat i ekspozimit ne monedha te ndryshme kryesisht ne lidhje me Euro-n dhe USD-n. Shoqeria nuk perdor ndonje instrument per tu mbrojtur ndaj rrezikut te kursit te kembimit. Drejtimi i shoqerise eshte perjegjes per te mbajtur pozicione neto te pershtatshme ne çdo monedhe dhe ne total dhe te monitoroje operacionet e perditshme.

Ekspozimi i shoqerise ndaj kursit te kembimit me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ka qene si me poshte:

31 dhjetor 2017	Euro	USD	Leke	Totali
Mjete Monetare	13,966,250	562,383	72,448,180	86,976,813
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	849,419	-	1,482,976	2,332,395
Totali	14,815,669	562,383	73,931,156	89,309,208
Detyrime per t'u paguar	11,072,346	35,916,237	36,927,725	83,916,308
Huamarje	148,097,138	44,440,000	-	192,537,138
Totali	159,169,484	80,356,237	36,927,725	276,453,446
Pozicioni Neto Valutor	(144,353,815)	(79,793,854)	37,003,431	(187,144,238)

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

31 dhjetor 2018	Euro	USD	Leke	Totali
Mjete Monetare	8,788,089	1,766,432	72,455,226	83,009,747
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	805,403	-	24,438,270	25,243,673
Totali	9,593,492	1,766,432	96,893,496	108,253,420
Detyrime per t'u paguar	14,523,223	22,350,947	21,281,580	58,155,750
Huamarje	90,222,019	21,564,000	-	111,786,019
Totali	104,745,242	43,914,947	21,281,580	169,941,769
Pozicioni Neto Valutor	(95,151,750)	(42,148,515)	75,611,916	(61,688,349)

(ii) *Risku i kreditit*

Rreziku i kreditit eshte rreziku i humbjes financiare per shoqerine nese klientet ose palet e tjera nuk permbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogarite e arketueshme te shoqerise. Eksposzimi i shoqerise ndaj rrezikut te kreditit eshte kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale te çdo klienti. Shoqeria krijon nje fond provigjoni per zhvleresim i cili perfaqeson vleresimet e shoqerise per humbjet e ndodhura ne lidhje me llogarite e arketueshme bazuar teresisht ne humbjet specifike te lidhura me ekspozime individualisht te rendesishme.

Rreziku maksimal i ekspozimit te shoqerise ndaj rrezikut te kreditit perfaqesohejt nga vlera e mbetur e seilit aktiv te pasqyres se pozicionit finanziar te paraqitur me poshte:

	2018	2017
Mjete monetare	83,009,747	86,976,813
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	25,243,673	2,332,395
Totali	108,253,420	89,309,208

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

(iii) Risku i normes se interesit

Te ardhurat e shoqerise dhe fluksi monetar operues jane thellesisht te pavarura nga ndryshimet ne treg te normes se interesit. Kompania nuk ka asete qe ndikohen ne menyre domethenese nga perqindja e interesit.

31 Dhjetor 2017	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktive financiare					
Mjete monetare	61,475,004	-	-	-	61,475,004
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	700,069	-	849,419	-	1,549,488
Totali	62,175,073	-	849,419	-	63,024,492
Detyrimet financiare					
Detyrime per t'u paguar	9,660,081	53,493,302	8,357,214	-	71,510,597
Huamarje	-	57,188,485	238,597,426	-	295,785,911
Totali	9,660,081	110,681,787	246,954,640	-	367,296,508
Hendeku i normes se interesit					
31 dhjetor 2016	52,514,992	(110,681,787)	(246,105,221)	-	(304,272,016)

31 Dhjetor 2018	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktive financiare					
Mjete monetare	83,009,747	-	-	-	83,009,747
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	24,280,060	-	974,861	-	25,254,921
Totali	107,289,807	-	974,861	-	108,264,668
Detyrimet financiare					
Detyrime per t'u paguar	38,978,906	10,599,575	7,627,356	-	57,205,837
Huamarje	-	-	111,786,019	-	111,786,019
Totali	38,978,906	10,599,575	119,413,375	-	168,991,856
Hendeku i normes se interesit					
31 dhjetor 2018	68,310,901	(10,599,575)	(118,438,514)	-	(60,727,188)

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

(c) Risku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit percaktohet si rreziku qe nje njesi ekonomike do te perballat me veshtiresi per te permbushur detyrimet qe lidhen me pasivet financiare. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj nevojave te perditishme per burime monetare, kryesisht per te shlyer detyrimet e krijuara gjate ushtrimit te aktivitetit te saj normal. Drejtimi monitoron çdo dite, jave dhe muaj duke bere parashikime per flukset e parave.

Tabela me poshte analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar ne periudhen e mbetur nga data e raportimit deri ne daten e maturimit sipas kontrates. Shumat e paraqitura ne tabelen me poshte jane flukset e parave te pa skontuara sipas kontrates. Balancat deri ne 12 muaj barazohen me vleren e tyre kontabel sepse ndryshimi me vleren e skontuar nuk eshte i konsiderueshem.

31 Dhjetor 2017	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	61,475,004	-	-	61,475,004
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	700,069	-	849,419	1,549,488
Totali	62,175,073	-	849,419	63,024,492
Detyrimet financiare				
Detyrime per t'u paguar	9,660,081	53,493,302	8,357,214	71,510,597
Huamarrie	-	57,188,485	238,597,426	295,785,911
Totali	9,660,081	110,681,787	246,954,640	367,296,508
Hendeku i likuiditetit te riskut me 31 dhjetor 2016	52,514,992	(110,681,787)	(246,105,221)	(304,272,016)
31 Dhjetor 2018	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	83,009,747	-	-	83,009,747
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	24,268,812	-	974,861	25,243,673
Totali	107,278,559	-	974,861	108,253,420
Detyrimet financiare				
Detyrime per t'u paguar	38,978,906	10,599,575	7,627,356	57,205,837
Huamarje	-	3,333,343	108,452,676	111,786,019
Totali	38,978,906	13,932,918	116,080,032	168,991,856
Hendeku i likuiditetit te riskut me 31 dhjetor 2018	68,299,653	(13,932,918)	(115,105,171)	(60,738,436)

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

5- Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Arka		
Leke	72,878	54,426
Euro	-	-
	72,878	54,426
Llogari rrjedhese		
Leke	72,382,348	72,393,754
Euro	8,788,089	13,966,250
Dollare Amerikane	1,766,432	562,383
	82,936,869	86,922,387
Totali	83,009,747	86,976,813

6- Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Kerkesat e arketueshme dhe te tjera te arketueshme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kerkesa te arketueshme nga klienti	1,026,912	1,225,226
Tatim mbi vleren e shtuar (DPD)	-	-
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	11,248	-
Tatimi ne burim i parapaguar	-	33,827
Parapagim detyrimesh raport kontrolli	23,241,900	-
Garanci qiradhenesve	805,403	805,403
Kerkesa te arketueshme nga punonjesit	-	-
Te tjera te arketueshme	169,458	223,923
Totali	25,254,921	2,288,379

Garancia ndaj qiradhenesve konsiston ne vleren e garancise te parashikuar ne kontraten e qirase operacionale te ambienteve ku vepron Shoqeria, e cila eshte e kthyeshme ne fund te afatit te qirase.

Shoqeria GFI Albania sh.p.k. ka parapaguar shumen e detyrimit qe rezulton nga "Raporti Perfundimtar te Kontrollit Tatimor Nr. 12724/2, date 02.05.2018 dhe Njoftimin e Vleresimit per Detyrimet Nr. 12724/3 Prot., date 02.05.2018", leshuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, prane Drejtorese se Tatimpaguesve te Medhenj, per Tatim Fitimin ne vleren 12,526,354 Leke dhe per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne vleren 10,715,546 Leke.

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

7- Inventari

Inventari i Shoqerise me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehet si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Komponente te markerit	84,707,141	75,480,221
Marker i gatshem per perdorim	7,185,489	2,348,826
Materiale ndihmese	3,439,120	4,095,530
Totali	95,331,750	81,924,577

Komponentet e markerit konsistojne ne koncentratin markues dhe ne perberesit e tjere te cilet, si rrjedhoje e nenshtrimit te nje procesi teknologjik perzierjeje, japos markerin e gatshem per perdorim, por, qe me 31 dhjetor 2018 nuk i jane nenshtruar ketij procesi dhe qendrojne te veçuara.

8- Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagine qiradhenesve	1,564,678	1,564,678
Shpenzime per t'u shperndare ne disa periudha	1,483,605	532,152
Parapagine furnitoreve	1,023,161	1,356,348
Parapagine te tjera	-	674,440
Totali	4,071,444	4,127,618

Parapagimet e dhena furnitoreve konsistojne kryesisht ne parapagine te dhena Global Fluids International S.A. per blerjet e markerit dhe pajisjeve te tjera te perdorshme gjate aktivitetit kryesor te Shoqerise.

Parapagimet e dhena qiradhenesve konsistojne ne garanci te dhena per kontratat e qirase operacionale te ambienteve ku vepron Shoqeria, te cilat jane te kthyeshme ne keste qiraje te parapaguara ne muajt e fundit te qirase.

Shpenzimet per t'u shperndare ne disa periudha konsistojne ne pjesen e paamortizuar te shpenzimeve administrative bankare qe Shoqeria ka parapagar per huamarrjen nga Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. e cila eshte e amortizueshme per gjithe periudhes se huamarrjes (shenimi shpjegues 13).

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e Flukseve te Parase
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

9- Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshtë:

	Toka	Ndertesa	Permiresime ne qiramarrje	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Orendi dhe pajisje zyre	Kompjutera dhe pajisje informatike	Total
Kosto historike								
Me31dhjetor2016	27,558,990	77,971,890	7,640,879	38,640,644	6,316,650	6,281,969	10,539,050	174,950,072
Shtesa	-	-	1,216,667	12,182,643	31,432,566	261,000	413,551	45,506,427
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-
Me31dhjetor2017	27,558,990	77,971,890	8,857,546	50,823,287	37,749,216	6,542,969	10,952,601	220,456,499
Shtesa	-	-	12,084,643	17,145,844	-	-	(879,705)	28,350,782
Pakesime	-	-	(1,869,110)	(1,645,346)	-	-	-	(3,514,456)
Me31dhjetor2018	27,558,990	77,971,890	19,073,079	66,323,785	37,749,216	6,542,969	10,072,896	245,292,825
Amortizimiakumuluar								
Me31dhjetor2016	-	(28,259,885)	(2,649,468)	(13,471,379)	(2,258,627)	(2,095,510)	(3,438,332)	(52,173,201)
Shtesa	-	(7,989,820)	(960,564)	(4,245,541)	(2,492,240)	(692,646)	(1,152,864)	(17,533,674)
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-
Me31dhjetor2017	-	(36,249,705)	(3,610,032)	(17,716,920)	(4,750,867)	(2,788,155)	(4,591,196)	(69,706,875)
Shtesa	-	(7,989,820)	(2,340,495)	(9,106,943)	(6,322,176)	(719,090)	(457,155)	(26,935,679)
Pakesime	-	-	-	838,818	-	-	-	838,818
Me31dhjetor2018	-	(44,239,525)	(5,950,527)	(25,985,045)	(11,073,043)	(3,507,245)	(5,048,351)	(95,803,737)
Vleraembetur								
Me31dhjetor2017	27,558,990	41,722,185	5,247,514	33,106,367	32,998,349	3,754,814	6,361,405	150,749,624
Me31dhjetor2018	27,558,990	33,732,365	13,122,552	40,338,740	26,676,173	3,035,724	5,024,545	149,489,088

Toka dhe ndertesa jane vendosur si kolateral per huane e marre nga Intesa Sanpaolo Bank sh.a. (shenimi shpjegues 13).

GFI Albania sh.p.k.
Pasqyra e Flukseve te Parase
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

10- Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Programe kompjuterike	Shpenzimet e nisjes	Total
Kosto historike			
Me 31 dhjetor 2016	4,720,353	-	4,720,353
Shtesa	-	-	-
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2017	4,720,353	-	4,720,353
Shtesa	5,840,450	31,227,670	37,068,120
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2018	10,560,803	31,227,670	41,788,473
Amortizim i akumuluar			-
Me 31 dhjetor 2016	(1,374,742)	-	(1,374,742)
Shtesa	(537,714)	-	(537,714)
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2017	(1,912,456)	-	(1,912,456)
Shtesa	(1,252,803)	(17,175,219)	(18,428,022)
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2018	(3,165,259)	(17,175,219)	(20,340,477)
Vlera e mbetur			
Me 31 dhjetor 2017	2,807,897	-	2,807,897
Me 31 dhjetor 2018	7,395,544	14,052,452	21,447,996

11- Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime

Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Te pagueshme ndaj Ministrise se Financave	10,599,575	10,415,735
Tatim mbi vleren e shtuar (DPT)	949,913	4,305,928
Sigurime shoq. dhe shend. dhe tatim mbi te ardhurat personale	3,492,644	3,648,040
Tatim ne burim	105,448	-
Tatimi mbi fitimin per tu paguar	-	15,052,710
Te pagueshme ndaj furnitoreve	32,324,197	39,445,756
Furnitore per fatura te pamberritura	112,083	138,986
Te pagueshme ndaj punonjesve	2,944,534	2,613,382
Te pagueshme ndaj ortakeve	7,627,356	8,216,310
Totali	58,155,750	83,836,847

Vlera e pagueshme ndaj Ministrise se Financave perben tarifen koncesionare te perllogaritur si 2.5% te ardhurave nga aktiviteti i Shoqerise, siç percaktohet ne Kontraten e Koncessionit.

Vlera e pagueshme ndaj ortakeve perben shpenzimet e nisjes te perballuara nga ortaket e Shoqerise para regjistrimit te kesaj te fundit.

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

12- Te ardhura te marra ne avance

Me 31 dhjetor 2018 Shoqeria ka te ardhura te marra ne avance nga klientet e saj si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Te ardhura te marra ne avance	6,040,439	4,816,630
Totali	6,040,439	4,816,630

13- Huamarrje

Huamarjet perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pjesa afatshkurter:		
Interesa	3,333,343	3,831,812
Hua bankare	45,005,720	46,162,089
	<hr/> 48,339,063	<hr/> 49,993,901
Pjesa afatgjate:		
Hua bankare	23,334,374	73,617,054
Hua nga Gold Coast Nominies sh.p.k.	21,564,000	44,440,000
Leasing	18,548,582	24,501,390
	<hr/> 63,446,956	<hr/> 142,558,444
Totali	111,786,019	192,552,345

Shoqeria ka nenshkruar nje kontrate huamarrje me Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. me date 17 maj 2013 per nje vlere prej 2,200,000 USD.Me date 11 shkurt 2016, eshte bere amendimi i kontrates se huamarjes se siperpermendur ku palet bien dakord per te ndryshojne monedhen e kredise nga USD ne Euro. Norma e interesit e aplikuar eshte LIBOR 1 vjeçar + 4%, por jo me e ulet se 5.3%.

Gjithashtu, Shoqeria ka nenshkruar dhe nje kontrate huamarrje me Gold Coast Nominies sh.p.k. me vlere 500,000 Dollare Amerikane me 7 maj 2013 serisht me qellim financimin e nevojave te Shoqerise per kapital qarkullues. Norma e interesit e aplikueshme sipas kontrates eshte 3% dhe kontrata eshte akorduar per 2.5 vjet me mundesi zgjatjeje pertej ketij afati.

Me ane te kontatave te qirase financiare Nr.040A, date 09.08.2017 dhe Nr.058A, date 19.12.2017 me shoqerine Albanian Financial Institution sh.p.k., shoqeria GFI Albania sh.p.k. ka marre me qira financiare 13 automjete.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

14- Provizione afatshkurtata

Provizonet afatshkurtame date 31 dhjetor 2018 jane si me poshte vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Provizon per ceshtje gjyqesore	10,447,274	
Totali	10,447,274	-

Shoqeria GFI Albania sh.p.k. eshte ne proces gjyqesor me Drejtorene e Tatimpaguesve te Medhenje, me objekt ankimimi “Raportin Perfundimtar te Kontrollit Tatimor Nr. 12724/2, date 02.05.2018 dhe Njoftimin e Vleresimit per Detyrimet Nr. 12724/3 Prot., date 02.05.2018”, leshuar nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, prane Drejtorese se Tatimpaguesve te Medhen.

Shoqeria ka krijuar provizion ne lidhje me gjobat dhe interesat sipas Raport Kontrollit.

15- Te ardhura nga aktivitetet e markimit

Te ardhurat nga aktiviteti i markimit konsistojne vetem ne te ardhuren nga sherbimi i markimit te hidrokarbureve te illogaritur ne baze te cmimit fiks per litra hidrokarburesh te markuara, sic parashikohet ne Kontraten e Koncesionit.

16- Te ardhura te tjera

Te ardhura te tjera jane si me poshte vijon:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga qiraja	2,297,430	-
Te ardhura nga dhuratat	443,700	-
Te ardhura nga zhdemtimet nga sigurimi	1,869,110	-
Totali	4,610,240	-

17- Kosto e markerit

Kosto e markerit perbehet nga kostoja e lendet markuese te perdorur gjate markimit te hidrokarureve sic parashikohet ne Kontraten e Koncessionit.

18- Kosto e punes

Kosto e punes perbehet si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Pagat e personelit	83,811,023	86,916,842
Shpenzimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore	11,012,707	11,321,515

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

Totali	94,823,730	98,238,357
---------------	-------------------	-------------------

19- Tarife koncessioni

Tarifa e koncessionit per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2018 konsiston ne shpenzimin e njojur nga Shoqeria per tarifen e koncessionit sipas Kontrates Koncesionare (shenimi shpjegues 10).

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Tarife koncesioni	10,599,577	10,415,737
Total	10,599,577	10,415,737

20- Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Shpenzime per sherbime komunale	1,111,379	1,655,551
Taksa lokale, shpenzime doganore dhe te ngjashme	553,408	881,523
Shpenzime qiraje ambientesh	9,302,964	9,428,346
Shpenzime qiraje automjetesh	(283,516)	4,753,946
Shpenzime per prime sigurimi	-	1,831,623
Sherbime ruajtje	3,300,000	3,300,000
Shpenzime konsulence ligjore dhe te ngjashme	7,342,495	7,074,220
Shpenzime konsulence financiare	5,665,204	3,811,414
Shpenzime laboratorike	597,069	436,497
Shpenzime transporti dhe karburanti	6,363,203	6,450,668
Shpenzime kancelarie	566,860	1,250,493
Shpenzime trajnimi	-	-
Shpenzime perfaqesimi	218,820	241,926
Shpenzime materiale konsumi	1,916,283	1,518,459
Shpenzime mirembajtje	4,602,723	1,078,046
Shpenzime komunikacioni dhe informacioni	1,624,143	1,534,119
Shpenzime per personelin (akomodim, dieta,uniforma etj.)	4,188,745	3,550,976
Shpenzime per gjoba	10,528,232	27,890
Shpenzime te ndryshme	1,452,155	994,193
Shpenzime konsulence tregtare dhe logistike	2,317,264	1,320,621
Shpenzime zhvleresimi nga permbytja	1,869,110	-
Shpenzime per koeficent moskreditimi	34,819	-
Total	63,271,360	51,140,511

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

21- Te ardhura (shpenzime) te tjera financiare, neto

Te ardhurat (shpenzimet) te tjera financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Te ardhura interesi:		
Depozite bankare	-	-
Shpenzime interesi dhe komisioni :		
Interesa overdraft (ISP)	-	(1,352,268)
Interesa hua bankare (ISP)	(4,460,575)	(7,523,253)
Interesa leasing	(1,480,452)	(277,837)
Interesa hua nga Gold Coast Nominies	(1,096,037)	(1,785,765)
Komisione bankare dhe leasing	(1,528,860)	(820,108)
	<u>(8,565,924)</u>	<u>(11,759,231)</u>
Shpenzime financiare, neto	(8,565,924)	(11,759,231)

22- Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto

Te ardhurat (shpenzimet) nga kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jane si me poshte :

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Fitime te realizuara nga kursi i kembimit	11,554,821	11,285,079
Fitime te parealizuara nga kursi i kembimit	373,480	6,351,185
	<u>11,928,301</u>	<u>17,636,264</u>
Humbje te realizuara nga kursi i kembimit	(101,399)	(644,608)
Humbje te parealizuara nga kursi i kembimit	(1,039,020)	(446,379)
	<u>(1,140,419)</u>	<u>(1,090,987)</u>
Fitime nga kembimi, neto	10,787,882	16,545,277

23- Tatim-fitimi

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme per tatimin mbi fitimin per vitin 2018 eshte 15% (2017:15%).

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara per qellime tatimi konsiderohen vetedeclarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

Shoqeria per vitin 2018 rezulton me fitim neto si per qellime kontabel ashtu dhe per qellime fiskale.

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Tatim-fitimi	25,664,312	25,052,710
TOTALI	25,664,312	25,052,710

Rakordimi i normes efektive te tatimit / i rezultatit kontabel me rezultatin fiskal

	%	2018	%	2017
Fitimi (Humbje) e vittit		149,872,629		158,151,779
Tatim-fitimi me shkallen tatimore standarde	15%	22,480,894	15%	23,722,767
Rregullime per:				
<u>Te ardhura te tatushme</u>	0%	-	0%	-
<u>Shpenzime te pazbritishme</u>				
Shpenzime administrative	0%	414,111	0%	321,184
Penalitete dhe humbje te tjera	1%	1,579,235	0%	26,106
Shpenzime amortizimi	1%	1,190,072	1%	982,653
Tatim-fitimi i vittit	17%	25,664,312	16%	25,052,710

Me 31 dhjetor 2018, Shoqeria nuk ka detyrime apo aktive tatimore te shtyra.

24- Pale te lidhura

Ne vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018, transaksionet me pale te lidhura i korrespondojne shumave te parapaguara ndaj tyre ne cilesine e furnitorit te Shoqerise me koncentrat markimi dhe pajisje te tjera.

	2018	2017
<i>Transaksione me Global Fluids International S.A.</i>	23,375,324	75,764,874
Kerkesa te arketueshme per blerje	22,352,163	74,408,526
Parapagime per furnizime	1,023,161	1,356,348
 <i>Transaksione me Petroleum Consulting Partners A.G.</i>	 3,041,632	 3,194,879
Kerkesa te arketueshme per blerje	-	-
Huamarje	-	-
Interesa	3,041,632	3,194,879

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

25- Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta.

Ne lidhje me "Raportin Perfundimtar te Kontrollit Tatimor Nr. 12724/2, date 02.05.2018 dhe Njoftimin e Vleresimit per Detyrimet Nr. 12724/3 Prot., date 02.05.2018", shoqeria eshte ne proces gjyqesor me Drejtorene e Tatimpaguesve te Medhenje.

26- Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

Me ane te shkreses date 19.11.2018 drejtuar Drejtorese se Apelimit Tatimor, Shoqeria kerkoi shfuqizimin e plote te Njoftim Vleresimit Tatimor nr. 10787 Prot. date 30/10/2018, sipas te cilit shoqeria duhet te paguante nje gjobe per Tatim mbi fitimin per vitin 2017 ne vleren 1,604,243 Leke. Me vendim nr.4991/1, date 18.01.2019, Drejtoria e Apelimit Tatimor vendosi shfuqizimin e Njoftim Vleresimit Tatimor nr. 10787 Prot. date 30/10/2018.